

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-2540 W

VESHJE EPOKSIDE ME 2 PËRBËRËS, BAZË UJI DHE ÇLIRIME TË ULËTA



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-2540 W është veshje me bazë rrëshire epokside për dyshemenë me 2 përbërës, bazë uji, çlirime të ulëta dhe me ngjyrë, e cila ofron një finiturë të lëmuar dhe të shkëlqyeshme me mirëmbajtje të ulët dhe pastrim me lehtësi. Për kushte konsumimi mesatare - të rënda. Përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

PËRDORIMET

Sikafloor®-2540 W duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Veshje epokside me ngjyrë për betonin, llaçe çimentoje, sisteme me spërkatje rëre dhe llaçe epokside.
- Ekspozim mekanik dhe kimik normal deri në mesatar.
- Për zona prodhimi, magazina, vende parkimi, garazhe, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Çlirime të ulëta VOC / AMC
- Rezistencë e mirë ndaj abrazionit
- Rezistencë e mirë kimike & mekanike
- I tretshëm në ujë
- Pa erë
- Aplikim i lehtë
- Finiturë me shkëlqim
- Mirëmbajtje e pakët

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 2 (Option 1): Building Product Disclosure and Optimization – Environmental Product Declarations
- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 4 (Option 2): Building Product Disclosure and Optimization - Material Ingredients
- Pajtueshmëri me LEED v4 EQc 2: Low-Emitting Materials
- Pajtueshmëri me LEED v2009 IEQc 4.2: Materiale me çlirime të ulëta - Bojëra & veshje
- Disponohet Deklarata e produktit rreth mjedisit (EPD) IBU
- Çlirimet DIBt, Sikafloor®-2540 W, eurofins, Raport testimi nr. G18793B
- VOC emission classification of building materials RTS M1
- VOC Emissions French Regulations, Sikafloor®-2540 W, eurofins, Raport nr. 392-2014-00087005C

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 1504-2 - Produkt për mbrojtjen e sipërfaqes së betonit - veshje
- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 13813 - Llaç dyshemeje me bazë rrëshire për përdorim të brendshëm në ndërtesa
- Rezistencë biologjike ISO 846, Sikafloor®-2540 W, CSM Fraunhofer, Miratim dhe certifikatë nr. SI 1212-624
- Dekontaminim DIN 25415, Sikafloor®-2540 W, ILF, Certifikatë nr. 170119
- Sistem për veshjen e dyshemesë DIN EN 13813, Sikafloor®-2540 W, DIBt, Miratim nr. Z-156.605-1300
- Sjellja e migrimit Sikafloor®-2540 W, ISEGA, Certifikatë 43250 U 16
- Çlirime degazimi VOC ISO 14644-1, Sikafloor®-2540 W, CSM Fraunhofer, Miratim dhe certifikatë nr. SI 1212-624
- Çlirime grimcash EU GMP Aneksi 1, Sikafloor®-2540

W, CSM Fraunhofer, Miratim dhe certifikatë nr. SI 1212-624

- Çlirime grimcash ISO 14644-1, Sikafloor®-2540 W, CSM Fraunhofer, Miratim dhe certifikatë nr. SI 1212-624
- Sliding Test, Sikafloor®-2540 W, Roxeler Baustoffprüfstelle, Raporte nr. 020227-17-9a, 020227-17-11a, 020227-17-8a



INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Epoksid, me bazë uji	
Ambalazhi	Përbërësi A	kovë 4,3 kg
	Përbërësi B	kovë 1,7 kg
	Përbërësit A+B	njësi 6.0 kg gati për përzierje
	Përbërësi A	kovë 13,0 kg
	Përbërësi B	kovë 5,0 kg
	Përbërësitt A+B	njësi 18,0 kg gati për përzierje
Paraqitja / Ngjyra	Rrëshira - përbërësi A	lëng me ngjyrë
	Forcuesi - përbërësi B	lëng transparent
	Disponohet në ngjyra të ndryshme. Ngjyrat e aplikuara që janë përzgjedhur nga tabela e ngjyrave do të jenë të përafërta. Rekomandohet se mostrat e aplikuara të ngjyrës duhet të krahasohen me ato të tabelës së ngjyrave nën kushtet e njëjta të ndriçimit përpara zgjedhjes përfundimtare. Kur produkti ekspozohet në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor, mund të ndodhë pak çngjyrosje dhe ndryshim në ngjyrë, por kjo gjë nuk ndikon në funksionin dhe performancën e veshjes. Produkti mund të përdoret në mjedise të jashtme, me kusht se fenomeni i çngjyrosjes të pranohet nga klienti.	
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5 °C dhe +30 °C.	
Dendësia	Përbërësi A	~1,33 kg/l (DIN EN ISO 2811-1)
	Përbërësi B	~1,09 kg/l
	Rrëshira e përzierë	~1,20 kg/l
	Të gjitha vlerat e dendësisë në +23 °C.	
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~55 %	
Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim	~43 %	
TË DHËNA TEKNIKE		
Rezistenca ndaj abrazionit	~63 mg (CS 10/1000/1000) (14 days / +23 °C) (DIN 53 109 Taber Abrader Test)	
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për informacione specifike.	

Rezistenca termike**Ekspozimi*****Nxehtësi e thatë**

I përhershëm

+60 °C

Afatshkurtër max. 7 ditë

+80 °C

Afatshkurtër max. 12 orë

+100 °C

Lagështi/nxehtësi e thatë afatshkurtër* deri në +80°C ku ekspozimi është vetëm rastësor (pastrim me avull, etj).

* Pa ekspozim të vazhdueshëm kimik dhe mekanik dhe vetëm në kombinim me sistemet Sikafloor® si një sistem më spërkatje rëre me trashësi ~ 3-4 mm.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN**Sistemet**

Referohuni në skedat teknike të sistemeve:

- Sikafloor® MultiDur WS-10
- Sikafloor® MultiDur WT-10

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN**Raporti i përzjerjes**

Përbërësi A : Përbërësi B = 72 : 28 (për peshë)

Konsumimi~0,2–0,3 kg/m² si veshje e aplikuar me rul mbi sipërfaqet e spërkatura me rërë.

Këto shifra janë teorike dhe nuk përlogarisin asnjë material shtesë për shkak të porozitetit të sipërfaqes, profilit të sipërfaqes, ndryshimeve në nivel, firon etj. Për informacione të detajuara, referohuni tek skedat teknike të sistemeve

Temperatura e mjedisit

+10 °C min. / +30 °C max.

Lagështia relative e ajrit

75 % max.

Pika e vesës

Kujdes kondensimin!

Nënshtrësja dhe dyshemeja e patharë duhet të jenë të paktën 3 °C mbi pikën e vesës për të reduktuar rrezikun e kondensimit ose humbjes së ngjyrës së sipërfaqes përfundimtare të dyshemesë. Temperaturat e ulëta dhe kushtet me lagështi të lartë shtojnë mundësinë e humbjes së ngjyrës.

Temperatura e nënshtrësës

+10 °C min. / +30 °C max.

Lagështia e përmbajtur e nënshtrësës

≤6 % pjesë për peshë përmbajtje lagështie.

Metoda e testimit: matësi Sika®-Tramex, matja CM ose metoda e tharrjes në furrë.

Pa rritje të lagështisë sipas ASTM (fletë polietileni).

Koha e punueshmërisë**Temperatura**

+10 °C

+20 °C

+30 °C

Koha

~120 minuta

~90 minuta

~45 minuta

Koha e maturimit

Përpara mbiveshjes së Sikafloor®-2540 W lini:

Temperatura e nënshtrësës

+10 °C

+20 °C

+30 °C

Min.

48 orë

20 orë

10 orë

Max.

7 ditë

5 ditë

3 ditë

Kohët jepen me përafërsi dhe do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të ambientit, veçanërisht temperatura dhe lagështia relative.

UDHËZIME APLIKIMI**CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA**

Nënshtrësata me bazë çimentoje (beton / llaç) duhet të kenë strukturë të qëndrueshme dhe me rezistencë të mjaftueshme ndaj kompresionit (min. 25 N/mm²) dhe rezistencë min. ndaj tërheqjes 1.5 N/mm².

Nënshtrësata duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa ndotje si pislëku, vaji, graso, veshje dhe trajtime sipërfaqesh, grimca të lira etj.

Nënshtrësata prej betoni duhet të përgatiten mekanikisht me pastrim me fryrje abrazive ose shkriktor për të hequr koren e çimentos dhe për të

arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur të përshtatshme për trashësinë e produktit.

Pjesët e dala mund të hiqen me smerilizim. Nënshtrësas e dobëta me bazë çimentoje duhet të hiqen dhe defektet e sipërfaqes si vrimat dhe boshllëqet duhet të ekspozohen plotësisht.

Riparimet mbi nënshtrësë, mbushja e plasaritjeve, vrimave/hapësirave dhe nivelimi i sipërfaqes duhet të kryhen me produktet e përshtatshme nga seria e materialeve Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard®. Produktet duhet të maturohen përpara aplikimit të Sikafloor®-2540 W.

I gjithë pluhuri, materiali i lirë dhe i shkrifët duhet të hiqet plotësisht nga të gjitha sipërfaqet përpara aplikimit të produktit, preferohet me furçë dhe/ose vakuum.

PËRZIERJA

Përpara përzierjes, përzieni mekanikisht përbërësin A (rrëshira) me një mikser elektrik në shpejtësi të ulët (300-400 rpm) për të përzierë lëngun dhe pigmentin derisa të arrihet një miks me ngjyrë të njëtrajtshme. Shtoni përbërësin B (forcuesi) tek përbërësi A dhe përzieni A + B vazhdimisht për 2,0 minuta derisa të arrihet një miks me ngjyrë të njëtrajtshme. Për të siguruar përzierjen e plotë, hidhini materialet brenda një ene të pastër dhe përzieni sërish për të paktën 1,0 minutë për të arritur një miks me konsistencë të lëmuar. Duhet të shmangët përzierja e tepruar për të pakësuar bllokimin e ajrit. Gjatë fazës përfundimtare të përzierjes, kruani anët e enës të paktën një herë për të siguruar përzierjen e plotë. Përzieni vetëm njësi të plota. Koha e përzierjes për A+B = 3,0 minuta.

APLIKIMI

Përpara aplikimit, konfirmoni përmbajtjen e lagështisë së nënshtrësës, lagështinë relative të ajrit dhe pikën e vesës.

Nëse përmbajtja e lagështisë është > 6% pjesë për peshë, mund të aplikohet Sikafloor® EpoCem® si një sistem barriere të përkohshme kundër lagështisë (temporary moisture barrier T.M.B.).

Prajmer

Hidhni prajmerin e përzierë Sikafloor® mbi nënshtrësën e përgatitur dhe aplikoni me furçë, rul ose shkop gome (squeegee) dhe kaloni me rul në dy drejtime në kënd të drejtë me njëri-tjetrin. Sigurohuni se një veshje e vazhdueshme dhe pa pore mbulon nënshtrësën. Nëse nevojitet, aplikoni 2 veshje prajmeri.

Konfirmoni se është arritur koha e pritjes / mbiveshjes përpara aplikimit të produkteve vijuese. Lexoni skedën teknike të prajmerit.

Veshje izoluese / përfundimtare

Në kohën e duhur për mbiveshje, derdhni Sikafloor®-2540 W e përzierë mbi nënshtrësën e përgatitur dhe aplikoni në mënyrë të njëtrajtshme me një rul najloni në raportin e kërkuar të konsumimit në dy drejtime në kënd të drejtë me njëri-tjetrin. Mund të arrihet një sipërfaqe përfundimtare pa bashkime nëse mbaresat e

pjesëve ruhen të lagështa gjatë aplikimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

MIRËMBAJTJA

PASTRIMI

Për të ruajtur paraqitjen e dyshemesë pas aplikimit, duhet të largohen menjëherë të gjitha rrjedhjet nga Sikafloor®-2540 W dhe duhet të pastrohet rregullisht me furçë rrotulluese, pastrues industrialë, fshesë për tharje, ujë me presion të lartë, shpëlarje dhe fshesë thithëse elektrike etj. duke përdorur detergjent dhe dyll të përshtatshëm.

DOKUMENTA SHITESË

- Sika® Method Statement: Evaluation and Preparation of Surfaces for Flooring Systems
- Sika® Method Statement: Mixing & Application of Flooring Systems
- Sika® Method Statement: Sikafloor®-Cleaning Regime
- System Data Sheet: Sikafloor® MultiDur WS-10
- System Data Sheet: Sikafloor® MultiDur WT-10

KUFIZIME

- Pas aplikimit, Sikafloor®-2540 W duhet të mbrohet nga lagështia, kondensimi dhe uji për të paktën 24 orë.
- Gjithmonë siguroni ventilim të mjaftueshëm me ajër gjatë përdorimit të Sikafloor®-2540 W në hapësira të mbyllura për të shmangur problemet gjatë tharjes.
- "Shkëlqimi" i sipërfaqes përfundimtare mund të variojë me temperaturën, lagështinë dhe absorbueshmërinë e nënshtrësës.
- Me ngjyrat e hapura (p.sh. e verdhë ose portokalli) mund të nevojitet aplikimi i disa veshjeve Sikafloor®-2540 W për të arritur patejdukshmëri të plotë (mbulueshmëri).
- Vlerësimi dhe trajtimi i gabuar i plasaritjeve mund të çojë në afat të reduktuar shërbimi dhe plasaritje reflektive.
- Për përputhje ekzakte ngjyrash, sigurohuni që në secilën sipërfaqe është aplikuar Sikafloor®-2540 W nga i njëjti numër prodhimi të serisë (batch number).
- Në kushte të caktuara, ngrohja nën dysheme ose temperaturat e larta të ambientit kombinuar me ngarkesa pikësore të mëdha, mund të lënë shenja në rrëshirë.
- Nëse kërkohet ngrohje, mos përdorni gaz, vaj ose vajgur apo ngrohës të tjerë me karburant fosilesh, pasi këto prodhojnë sasi të mëdha CO₂ dhe avujsh ujë H₂O, të cilat mund të ndikojnë negativisht mbi sipërfaqen përfundimtare. Për ngrohje përdorni vetëm sisteme elektrike me ventilim ajri të ngrohtë.
- Mos aplikoni Sikafloor®-2540 W mbi nënshtrësas me lagështi në rritje.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42/CE, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (kategori produkti IIA / j lloji wb) është 140 g/l (Kufizimet 2010) për produktin gati për përdorim.

Përmbajtja maksimale e Sikafloor®-2540 W është ≤ 140 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-2540 W

Shtator 2019, Botimi 05.01

020811010020000008

Sikafloor-2540W-sq-AL-(09-2019)-5-1.pdf